

**ikub.al shpk**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

---

**PËRMBAJTJA:**

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	13,945,659	268,500
Llogari te arketueshme tregetare	5	3,751,587	11,575,865
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	11,001,576	10,663,445
Te tjera llogari te arketueshme	7	362,181	628,300
Shpenzime te shtyra	8	58,114	426,122
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>29,119,117</b>	<b>23,562,232</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	9	1,105,429	1,154,964
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>1,105,429</b>	<b>1,154,964</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>30,224,546</b>	<b>24,717,196</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari te pagueshme tregetare	10	1,578,070	10,450,270
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	11	12,236,417	11,976,179
Detyrime tatimore	12	7,343,468	1,945,410
Te tjera detyrime	13	1,280,940	1,396,632
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>22,438,895</b>	<b>25,768,491</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari te pagueshme nga palet e lidhura	14	4,312,160	4,377,760
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>4,312,160</b>	<b>4,377,760</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>26,751,055</b>	<b>30,146,251</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nenshkruar	15	2,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		88,186	88,186
Rezerva te tjera		(7,517,241)	(4,149,398)
Fitimi i ushtrimit		8,902,546	(3,367,843)
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>3,473,491</b>	<b>(5,429,055)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>30,224,546</b>	<b>24,717,196</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	58,852,833	30,989,280
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	17	(135,247)	(47,348)
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		<b>(20,678,805)</b>	<b>(18,422,330)</b>
Lenda e pare dhe materiale te			
1) konsumueshme	18	(16,628,637)	(10,953,108)
2) Te tjera shpenzime	19	(4,050,168)	(7,469,222)
<b>Shpenzime te personelit</b>	20	<b>(27,110,635)</b>	<b>(14,988,154)</b>
1) Paga dhe shperblime		(24,190,518)	(12,808,128)
2) Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(2,920,117)	(2,180,026)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(284,701)	(256,379)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	21	(1,610)	(543,636)
<b>Shpenzime financiare</b>		<b>(83,396)</b>	<b>(99,276)</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		-	-
1) ekonomike brenda grupit		-	-
2) Shpenzime te tjera financiare	22	(83,396)	(99,276)
<b>Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet</b>			
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>10,558,439</b>	<b>(3,367,843)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	23	<b>(1,655,893)</b>	<b>-</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,655,893)	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>8,902,546</b>	<b>(3,367,843)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"ikub.al" shpk


(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014</b>	<b>2,000,000</b>	<b>88,185</b>	<b>1,675,523</b>	<b>(5,824,920)</b>	<b>(2,061,212)</b>
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015</b>					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					-
Fitimi / Humbja e vitit				(3,367,843)	(3,367,843)
Lëvizjet përmes kapitalit			(5,824,920)	5,824,920	-
Dividendë të paguar			-	-	-
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,000,000</b>	<b>88,185</b>	<b>(4,149,397)</b>	<b>(3,367,843)</b>	<b>(5,429,055)</b>
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016</b>					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				8,902,546	8,902,546
Lëvizjet përmes kapitalit			(3,367,843)	3,367,843	-
Dividendë të paguar			-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,000,000</b>	<b>88,185</b>	<b>(7,517,240)</b>	<b>8,902,546</b>	<b>3,473,491</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori ikub.al shpk më 17.03.2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Ana QOSE  
Ekonomist

  
Etleva BAZI  
Administrator



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	8,902,546	(3,367,843)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(65,612)	(37,724)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	284,701	256,379
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	8,120,274	(11,559,653)
Rënie/(rritje) në inventarë	-	1,422,868
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(1,964,014)	9,980,148
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(1,216,632)	902,632
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>14,061,263</b>	<b>(2,403,193)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(235,167)	(462,057)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(235,167)</b>	<b>(462,057)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Pagesa e huave	-	(61,118)
Interes i paguar	(148,950)	(133,778)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>(148,950)</b>	<b>(194,896)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>13,677,146</b>	<b>(3,060,146)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	268,500	3,321,323
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	13	7,323
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor</b>	<b>4</b>	<b>13,945,659</b>
		<b>268,500</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ikub.al Shpk" Shpk është krijuar në vitin 2006. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Per Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

"ikub.al" Shpk është një shoqëri Shqiptare. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

- Investment SHERKO - ikub GROUP, 90% e kapitalit
- Albert Tollkuçi – 10% e kapitalit.

Selia e shoqërisë ndodhet në Rr. Ismail Qemali Tirane. Ajo është regjistruar në Degen e Tatimeve, Tirane me NR. NIPT K62217018V.

Administrator i shoqërisë është Znj.Etleva Bazi.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: Qender informacioni për grumbullimin, përpunimin, e shpërndarjen e sistemeve të informacionit; Qender konsulence për aktivitete të ndryshme; Konceptim, zhvillim e mirëmbajtje të sistemeve të TIK; Shtypshkrime, botime, printime, fotokopjime, shumefishime; Pjesëmarrje, ndërmjetësim e investime në fushat e shërbimeve, turizmit, tregtisë, ndërtimit, prodhimit, etj; Pjesëmarrje, ndërmjetësim e investime në tregun e pasurive të paluajtshme e tregjet financiare. Import-Eksport për mallra, shërbime etj.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 28 punonjës (2015: 55 punonjës).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë të raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe

supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79

### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.3. Aktive afatgjata materiale

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### 3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### 3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### 3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

### 3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet

aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

### 3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### 3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Mjete monetare ne banke	12,827,432	55,086
Llogari rrjedhese	12,827,432	55,086
Mjete monetare ne arke	1,118,227	213,414
	<b>13,945,659</b>	<b>268,500</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregëtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Kliente	3,751,587	11,575,865
	<b>3,751,587</b>	<b>11,575,865</b>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
ikubINFO	10,520,000	10,120,000
IT Panakeia / IkubINFO Software Solutions	481,576	56,489
Intelligent Systems Albania	-	46,535
Pragmatic Software	-	440,421
	<b>11,001,576</b>	<b>10,663,445</b>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Tatim mbi fitimin	-	219,582
TVSH per t'u rregulluar	362,181	46,890
Rimbursime nga Sig.Shoqerore	-	57,712
Te tjera kerkesa te arketueshme	-	304,116
	<b>362,181</b>	<b>628,300</b>

**8. Shpenzime te shtyra**

Gjendjet e parapagimeve me 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 jane si me poshte :

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Parapagime per blerje	-	426,122
Shpenzime te periudhave te ardheshme	58,114	-
	<b>58,114</b>	<b>426,122</b>

**9. Aktive Afatgjata Materiale**

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
<b>Kosto</b>				
Gjendja më 1 Janar 2015	1,869,537	1,807,636	40,000	3,717,173
Shtesa	81,232	359,047	21,777	462,056
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>1,950,769</b>	<b>2,166,683</b>	<b>61,777</b>	<b>4,179,229</b>
Shtesa	42,152	193,014	0	235,166
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>1,992,921</b>	<b>2,359,697</b>	<b>61,777</b>	<b>4,414,395</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
Gjendja më 1 Janar 2015	(1,344,667)	(1,390,154)	(33,065)	(2,767,886)
Amortizimi i vitit	(116,639)	(136,483)	(3,257)	(256,379)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>(1,461,306)</b>	<b>(1,526,637)</b>	<b>(36,322)</b>	<b>(3,024,265)</b>
Amortizimi i vitit	(102,471)	(177,144)	(5,086)	(284,701)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(1,563,777)</b>	<b>(1,703,781)</b>	<b>(41,408)</b>	<b>(3,308,966)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>				
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>524,870</b>	<b>417,482</b>	<b>6,935</b>	<b>949,287</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>489,463</b>	<b>640,046</b>	<b>25,455</b>	<b>1,154,964</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>429,144</b>	<b>655,916</b>	<b>20,369</b>	<b>1,105,429</b>

#### 10. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Furnitore	1,503,350	10,397,187
Furnitore per fatura te pa mberitura	74,720	53,083
	<b>1,578,070</b>	<b>10,450,270</b>

#### 11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Te pagueshme tregtare-Investment Sherko	546,462	396,089
Te pagueshme tregtare-IT Panakeia	10,805	-
Financim Investments Sherko	9,820,800	8,700,800
Financim Pragmatic Software	-	1,100,940
Financim Albert Tollkuci	560,000	480,000
Hua-IT Panakeia	1,298,350	1,298,350
	<b>12,236,417</b>	<b>11,976,179</b>

#### 12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor</b>	<b>31 Dhjetor</b>
	<b>2016</b>	<b>2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	331,267	467,370
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punesimi	1,504,235	45,367
Tatim ne Burim	108,131	95,268
Tatim fitimi	1,436,311	-
TVSH per t'u paguar	3,963,524	1,337,405
	<b>7,343,468</b>	<b>1,945,410</b>

### 13. Të tjera detyrime

Detyrime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Detyrime ndaj personelit	180,000	1,396,632
Financim Pragmatic Software	1,100,940	-
	<b>1,280,940</b>	<b>1,396,632</b>

### 14. Detyrime afatgjata

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatgjata nga Ortaku Investment Sherko-ikub Group. Më poshtë janë paraqitur këto hua me 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Hua financiare Inv Sherko	4,312,160	4,377,760
	<b>4,312,160</b>	<b>4,377,760</b>

### 15. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke, perkatesisht:

- Investment SHERKO - ikub GROUP shoqeri e cila zoteron 90% te kuotave te kapitalit dhe
- Albert Tollkuçi i cili zoteron 10% te kuotave te kapitalit.

### 16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Zhvillim aplikacioni, programime	31,965,254	9,119,617
Reklama ne portal	22,937,230	16,905,964
Reklama ne librin e biznesit	2,783,683	4,963,699
Qera platforma ebuy.al	1,166,666	-
	<b>58,852,833</b>	<b>30,989,280</b>

**17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Fitime nga kembimet valutore	222,544	176,332
Humbje nga kembimet valutore	(357,791)	(223,680)
	<b>(135,247)</b>	<b>(47,348)</b>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<b>Dhjetor 31, 2016</b>
<b>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</b>	
Shitje total te deklaruara ne FDP TVSH	58,852,833
<b>Shitje te dekluar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH</b>	<b>58,852,833</b>
Sherbime	58,852,833
<b>Te ardhura te deklaruara ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP</b>	<b>58,852,833</b>
Te ardhurat nga interesat	63
Fitim nga kembimet valutore	288,144
<b>Total te ardhura te deklaruara FDP e Tatim Ftimit</b>	<b>59,141,040</b>

**18. Lëndet e para dhe shërbimet**

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Qira	5,421,477	2,598,895
Reklama	8,875,102	5,768,842
Shpenzime per Marketing	271,886	470,120
AKEP	75,000	85,000
Internet	1,451,612	382,044
Sherbime informatike	533,560	1,648,207
	<b>16,628,637</b>	<b>10,953,108</b>

### 19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Shpenzime karburanti	264,900	503,600
Shpenzime komunikimi	541,631	860,094
Konsulence juridike, financiare	382,807	414,515
Shpenzime sigurim/noterizim/perkthim	5,460	44,226
Taksa vendore	67,000	25,120
Mirembajtje ambiente, pajisje	163,445	154,202
Shpenzime postare	680,353	250,008
Udhetime dhe dieta	-	61,607
Shpenzime kancelarie e te ngjashme	220,976	151,518
Komisione bankare	348,436	269,339
Shpenzime te tjera	290,778	508,801
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	1,084,382	4,226,192
	<b>4,050,168</b>	<b>7,469,222</b>

### 20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Shpenzime per paga	24,190,518	12,808,128
Shpenzime per sigurime shoq e shend	2,920,117	2,180,026
	<b>27,110,635</b>	<b>14,988,154</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 28 (2015:55).

### 21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>ne Lek</b>	<b>ne Lek</b>
Gjoba dhe penalitete	1,610	543,636
	<b>1,610</b>	<b>543,636</b>

## 22. Shpenzime financiare Neto

	31 Dhjetor 2016 ne Lek	31 Dhjetor 2015 ne Lek
Shpenzime per interesa	(149,059)	(133,782)
Te ardhura nga interesat	63	4,104
Te ardhura nga kembimet valutore	65,600	30,402
	<b>(83,396)</b>	<b>(99,276)</b>

## 23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2015;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>10,558,439</b>	<b>(3,367,843)</b>
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	<b>1,085,992</b>	<b>4,769,829</b>
Shpenzime pritje & percjellje	16,985	87,500
Penalitet, gjoba e demshperblime	1,610	543,636
Shpenzime pa fature te rregullt tatimore	1,067,397	4,138,693
<b>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</b>	<b>11,644,431</b>	<b>1,401,986</b>
Humbje fiskale e mbartur nga viti 2014	(605,146)	(1,401,986)
<b>Rezultati Fiskal</b>	<b>11,039,285</b>	-
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>(1,655,893)</b>	-
<b>Fitimi/humbja e Vitit</b>	<b>8,902,546</b>	<b>(3,367,843)</b>

## 24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Bilanci kontabël</b>		
<u>Të arketueshme nga palët e lidhura</u>		
ikubINFO	10,520,000	10,120,000
IT Panakeia / ikubINFO Software Solutions	481,576	56,489
Intelligent Systems Albania	-	46,535
Pragmatic Software	-	440,421
	<b>11,001,576</b>	<b>10,663,445</b>

Të pagueshme ndaj paleve të lidhura

Te pagueshme tregtare-Investment Sherko	546,462	396,089
Te pagueshme tregtare-IT Panakeia	10,805	-
Financim Investments Sherko	9,820,800	8,700,800
Financim Pragmatic Software	-	1,100,940
Financim Albert Tollkuci	560,000	480,000
Hua-IT Panakeia	1,298,350	1,298,350
	<b>12,236,417</b>	<b>11,976,179</b>

Për vitin e mbyllur  
më 31 Dhjetor  
2016

Për vitin e mbyllur  
më 31 Dhjetor  
2015

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Shitje palëve të lidhura

ikubINFO	32,288,589	9,109,726
IT Panakeia	2,049,047	702,803
Intelligent Systems Albania	-	574,056
Pragmatic Software	-	1,881,772
	<b>34,337,636</b>	<b>12,268,357</b>

Blerje nga palët e lidhura

Investment Sherko	148,950	133,778
IT Panakeia	10,805	-
	<b>159,755</b>	<b>133,778</b>

**25. Angazhime dhe pasiguri**

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

**26. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.